

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT TIRANE
Nr. 13489 Akt.

V E N D I M
PER RREGJISTRIMIN E PERSONIT JURIDIK

Sot me date 6-12-1995, une gjyqtarja e Gjykates se Rrethit Tirane, M. Doli si shqyrtova kerkesen dhe materialet e paraqitura nga Ministria e Financave per regjistrimin e shoqerise tregtare: "Parku i Transportit te Udhetareve Shkoder" ne formen e nje shoqerie anonime :

KONSTATOVA SE :

Kerkuesi Ministria e Financave ka paraqitur kerkesen per t'u rregjistruar si person juridik shoqerine ne formen e nje shoqerie anonime " Parku Udhetareve Shkoder" me kohezgjatje pa afat te caktuar, me kapital themeltar 18.801.000 leke me aksionist te vetem Ministrine e Financave, perfaqesuar nga Drejtoria e Shoqerive Publike, me vlere nominale te aksionit 1.000 leke me objekt veprimtarie: Sherbim te transportit ne sherbim te popullates, kryesisht sherbim urban dhe pjeserisht disa linja me fshatra te aferta te rrethit.

Dokumentacioni i paraqitur, akti i themelimit, statuti, Urdher Nr. 95, date 24.11.1995 i Ministrise se Financave, kerkese per miratim eksperti jane te plote dhe te bazuar ne ligj dhe si te tille duhet te pranohen.

PER KETO ARSYE :

Ne baze te Ligjit Nr. 7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite Tregtare", si dhe nenit 33 ligjit Nr. 7667, date 28.01.1993 Per rregjistrin tregtar dhe formalitetet qe duhen plotesuar ne te".

V E N D O S A

Rregjistrimin si person juridik te shoqerise anonime "Parku Udhetareve Shkoder" me kohezgjatje pa afat te caktuar kapital themeltar 18.801.000 leke me aksionist te vetem Ministrine e Financave, perfaqesuar nga Drejtoria e Shoqerive Publike, me vlere nominale te aksionit 1.000 leke dhe me objekt veprimtarie: Sherbim te transportit ne sherbim te popullates, kryesisht linja me fshatra te aferta te rrethit. Selia e shoqerise eshte ne Shkoder.

Keshilli Mbikqyres perbehet nga :

1. Defrim Quku
2. Maksim Tashi
3. Naim Sula

Kunder vendimit lejohet ankim ne shkalle te dyte.

VERIFIKOHET JESIA
ME ORIGINALIN
NOTERE
VIOLETA : SULKAJ

GJYQTARE
TIRANE
Doli



perkatese te regjistrit ne kolonen nr 4 dhe 5 me numer rendor 3 me kete permbajtje
:

Vendim per zgjedhjen e keshillit mbikqyres me keta anetare
me kete perberje

1. Defrim Quku.
2. Arben Maho
3. Gjyzela Sata

Vendim i Asamblese per ndryshimet ne statut dhe aktin e themelimit

Te ndahen regjistrimet me vije nga njeri tjetri

GJYQTARE



AKT THEMELIMI I SHOQERISE ANONIME

Ne Tirane, sot me date 21.08.1995, Ministria e Financave, ne baze te ligjit Nr.7926, date 20.04.1995 "Per transformimin e ndermarrjeve shteterore ne shoqeri tregtare" Ministri i Financave, vendosi

1. Te krijoj shoqerine anonime " Parku Udhetareve Shkoder".
2. Objekti i veprimtarise se shoqerise do te jete: Sherbim te transportit ne sherbim te popullates, kryesisht sherbim urban dhe pjeserisht disa linja me fshatra te aferta te rrethit.
3. Shoqeria do te kete seline e saj ne Shkoder dhe ajo mund te çele dege, filiale, agjensi dhe perfaqesi ne te gjithë territorin e Republikes se Shqiperise dhe me miratimin e organeve kompetente edhe jashte shtetit.
4. Kapitali themeltar i shoqerise eshte 18.801.000 leke, i ndare ne 18.801 aksione me vlere nominale 1.000 per aksion.
5. Shoqeria ka nje kohezgjatje te veprimtarise se saj pa afat te caktuar.
6. Keshilli i pare mbikqyres perbehet nga :
 1. Defrim Quku
 2. Maksim Tashi
 3. Naim Sula
7. Ndertimi, organizimi dhe funksionimi i shoqerise rregullohet sipas dispozitave te legjislacionit shqiptar si dhe ne baze te statutit dhe ketij akti themelimi.
8. Shoqeria fillon veprimtarine me nenshkrimin dhe miratimin e dokumentave te saj themelues.

DREJTORI I DREJTORISE SE SHOQERIVE PUBLIKE

BERZH PIRANIAN